



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2026

VENDIM
Nr. 89, datë 18.02.2026

PËR
TRANSFERIMIN E GJYQTARES ZNJ. ARDIOLA ÇELA NË PROCEDURËN E
LËVIZJES PARALELE NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, në shkronjën “ç”, të nenit 86 dhe nenit 97 e 98, të Ligjit nr.115/2016, “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, në pikën 7,10 dhe 12, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016, “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “*Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve*”, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e tij nr. 84, datë 20.02.2024, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve,

VENDOSI:

1. Transferimin e gjyqtares znj. Ardiola Çela në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë në datë 19.02.2026.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. Ardiola Çela, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016, “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit Durrës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR